

## Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor Vlerësim i ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundërpërgjigja e vendeve<sup>1</sup>

- *Tronditjet e pandemisë COVID-19 mbi sistemet arsimore do të kenë ndikim negativ afatshkurtër dhe afatgjatë. Rezultatet ekonomike të arritura mund të frenohen, rritja e kapitalit njerëzor ka të ngjarë të ulet ose të ndalojë, ndërsa hendeqet aktuale në krijimin e kushteve të barabarta në procesin e të mësuarit priten të zgjerohen.*
- *Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor i janë përgjigjur ndërprerjes së mësimdhënies përmes futjes së mënyrave të ndryshme të mësimdhënies në distancë. Megjithatë, pavarësisht reagimit të shpejtë, humbjet në procesin e të nxënësve do të jenë të pashmangshme dhe të konsiderueshme, duke prekur në mënyrë shpërpjestimore grupet e cënueshme, ku një pjesë e nxënësve që do të bien përsëri në analfabetizëm funksional dhe mbase edhe do ta braktisin fare shkollën. Vlerësimet sugjerojnë që numri i nxënësve me rezultate nën aftësitë bazë në lexim mund të rritet nga 53 përqind në 61 përqind.*
- *Ndërsa shkollat mbeten të mbyllura ose janë rihapur pjesërisht, intensifikimi i mësimit në distancë dhe mbështetja për mësuesit dhe prindërit mund të pakësojnë humbjet në procesin e të nxënësve. Programet e përshpejtuara të të mësuarit për t'u kompensuar nxënësve humbjet në procesin e të nxënësve si dhe një buxhet i përshtatshëm për arsimin që të sigurojë kushte minimale për përballimin e kostove shtesë në periudhën pas COVID-19, do të jenë thelbësore për të siguruar që nxënësit të kapin ritmin si dhe për të parandaluar pabarazi të mëtejshme.*
- *Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të shfrytëzojnë mundësinë për ta bërë arsimin më eficient, gjithëpërfshirës dhe elastik. Përmirësimi dhe shkallëzimi i politikave në përgjigje të COVID-19 që kanë funksionuar, përfshirë uljen e ndarjes digjitale dhe përfundimin e aftësive digjitale të mësuesve do të sillnin qëndrueshmëri të sistemit ndaj goditjeve të ardhshme. Për më tepër, përqëndrimi te parandalimi i braktisjes së shkollës, përmirësimi i arsimit të hershëm dhe shërbimet përkujdesëse me në qendër fëmijët nga grupet e cënueshme, intensifikimi i aftësimin të mësuesve, rritja e financimit të arsimit dhe monitorimi i performancës do të çojnë në përmirësime të cilësisë së arsimit dhe barazisë në planin afatmesëm.*

### 1. Si po reagojnë sistemet arsimore në Ballkanin Perëndimor ndaj COVID-19-ës?

**Ndikimi i pandemisë lidhet së shumti me mbylljet e shkollave dhe kalimin drejt mësimit në distancë.** Mbylljet po prekin mbi 90 për qind të nxënësve në botë, dhe kanë lënë 1,6 miliardë nxënës jashtë shkolle<sup>2</sup>. Mbylljet aktuale të shkollave do të çojnë në humbje të të nxënësve për të gjithë nxënësit, dhe do të prekin në mënyrë shpërpjestimore nxënësit e disavantazuar, të cilët kanë më shumë gjasa ta lënë shkollën, apo të largohen nga shkolla më herët. Këto ndikime negative do të kenë pasoja edhe afatshkurtra, edhe afatgjata. Përfitimet ekonomike mund të frenohen, rritja e kapitalit njerëzor me gjasë do të ngadalësohet apo do të ndalohet, dhe, çfarë është më e rëndësishmja, do të zgjerohet hendequ aktual i barazisë së mundësive të të nxënësve.

<sup>1</sup> Ky pjesë është përgatitur nga Flora Kelmendi, James Gresham dhe Syedah Aroob Iqbal. Autorët kanë marrë parasysh komentet dhe kontributet e Harry Patrinos, Jamele Rigolini, Maria Pomes Jimenez, Amer Hasan, Alexandria Valerio, Bojana Naceva dhe Angela Demas.

<sup>2</sup> Shifrat përkohëse me numrin e nxënësve të regjistruar në nivelet parashkollore, shkollore (filllore, cikli i lartë fillor dhe të mesme) [nivelet ISCED 0 deri në 3], si dhe të studentëve në arsimin e lartë [nivelet ISCED 5 deri në 8]. Shifrat e regjistrimit bazohen në të dhënat më të fundit të Institutit për Statistikat të UNESCO-s.

**Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë kombinuar masat parandaluese për të penguar përhapjen e virusit me masa lehtësuese për të ofruar vazhdimësi në arsimim.** Të gjitha vendet në rajon reagon shpejt, duke mbyllur shkollat dhe miratuar masa të tjera parandaluese, sapo u konfirmuan rastet e para (9-13 mars, 2020). Në Ballkanin Perëndimor, të gjitha institucionet e arsimit të lartë (Kutia 1) janë mbyllur, ndërkohë që janë prekur drejtpërdrejt 2,7 milionë nxënës parauniversitarë.

**Për të siguruar vazhdimësi të të nxënësve ndërkohë që shkollat u mbyllën, vendet kanë prezantuar një sërë metodash për mësimin në distancë në situatë emergjence.** Masat për mësimin në distancë përfshijnë një spektër të gjerë mekanizmash për ofrimin e tij: transmetimet radio-televizive, burime të ngarkuara në faqe të posaçme interneti, mësim të zhvilluara *online*, dhe kontakte me nxënësit përmes telefonave celularë. Më shpesh, vendet kanë vendosur për një kombinim metodash. Në rajon, për të patur akses në sa më shumë nxënës, qeveritë janë mbështetur më së shumti në transmetimet televizive të mësimave të regjistruara. Megjithatë, për të ofruar mësim televiziv në shkallë të madhe, si lëndët e mbuluara, edhe koha e mësimdhënies janë kufizuar së tepërmi. Burimet për mësuesit, për t'u përshtatur me mësimdhënien në distancë, po bëhen të disponueshme edhe *online* në platforma dhe faqe interneti të posaçme. Disa vende që po e përgatitnin sistemin për mësimin *online* i kanë përshpejtuar këto përpjekje për t'u përgjigjur më mirë rrethanave aktuale<sup>3,4</sup>. Vendet janë angazhuar edhe për ta zvogëluar mospërfshirjen dhe humbjet e të nxënësve midis nxënësve më të cenueshëm<sup>5</sup>, si dhe po shqyrtojnë mundësinë e propozimeve për ndryshimin e kalendarit mësimor, duke përshtatur ditët e pushimit, dhe duke ofruar pajisje të TIK-ut për nxënësit<sup>6</sup>.

**Pavarësisht masave të shpejta në të gjithë rajonin, mbylljet e shkollave dhe format më pak efektive të mësimin në distancë do të çojnë pashmangshmërisht në humbje të të nxënësve dhe do të thellojnë hendekun e barazisë së mundësive për të nxënë.** Kalimi drejt mësimin *online* në shkallë të madhe

#### **Kutia 1: Çfarë po ndodh me arsimin e lartë?**

Institucionet e arsimit të lartë në rajon janë mbyllur përkohësisht, ndërsa më shumë se 600.000 studentë universitetesh janë detyruar papritur ta kalojnë mësimin *online*, për të lehtësuar procesin e mbylljes së universiteteve. Në përgjithësi, kapaciteti i sistemit arsimor në nivelin universitar është shumë më i lartë. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për aftësitë dhe mundësitë për përdorimin e teknologjisë, si dhe autonomia e studentëve. Prandaj, mësimet ofrohen *online*. Kryesisht, universitetet e Ballkanit Perëndimor janë mbështetur për mësimdhënie te platforma të jashtme videokonferencash, të tilla si Zoom-i, Skype-i, dhe më së shumti te Google Classroom-i. Megjithatë, lëndët që kërkojnë eksperiencë praktike, punë laboratorike, apo klinika, nuk mund të zhvillohen përmes internetit. Manuale dhe udhëzime të tjera janë përgatitur për t'i ndihmuar profesorët në lëvizjen drejt internetit (p.sh., në Kosovë, Universiteti i Prishtinës ka nxjerrë udhëzime për ofrimin e mësimin *online*, p.sh. si të zhvillohen leksione *online* në platformën Google).

është shumë i vështirë, sepse ai është vërtet i ndërlikuar edhe në rrethanat më të mira<sup>7</sup>. Në këtë pandemi, ky kalim ishte i befte. Gatishmëria e vendeve për të ofruar arsimim cilësor për të gjithë, duke përdorur modalitete në distancë dhe *online* është thelbësore

<sup>3</sup> <https://www.srbija.gov.rs/tekst/en/137330/esdnevnik.php>.

<sup>4</sup> <https://montk.gov.ba/odluka-o-organizaciji-online-nastave-i-instrukcija/1812/>.

<sup>5</sup> Për shembull, Mali i Zi po shqyrton mundësinë e një marrëveshjeje me operatorët e telekomunikacionit për të ofruar plane të pakufizuara interneti për nxënësit që kanë më pak gjasa të përdorin internet me shpejtësi të lartë. Po ofrohet mbështetje edhe për fëmijët refugjatë dhe migrantë në qendra të përkohshme të pritjes në Bosnjë-Hercegovinë. <https://news.un.org/en/story/2020/04/1060982>.

<sup>6</sup> <https://enastava.skolers.org/> <http://www.eobrazovanje.com/vijesti/Pages/nastava-na-daljnu.aspx>.

<sup>7</sup> Banka Botërore (2020). Dokument informues për reagimin e shpejtë: Mësimi në distancë dhe përhapja e COVID-19-s (anglisht – Rapid Response Briefing Note: Learning and COVID-19 Outbreak). Uashington, DC: World Bank Group.

për të vlerësuar se si do të ndikojë reagimi ndaj COVID-19-ës te akumulimi i kapitalit njerëzor në kuadrin afatmesëm.

## **2. Sa të përgatitura janë shtetet për të ofruar arsimim cilësor për të gjithë, duke përdorur modalitetet e mësimdhënies në distancë dhe *online* për një periudhë të zgjatur?**

**Ndonëse nuk dihet se si do të evoluojë pandemia në Ballkanin Perëndimor, pritet që shkollat të mbeten të mbyllura edhe gjatë muajve të verës dhe, madje, mund të mos rihapen as vitin e ardhshëm akademik.** Gjithashtu, ka të ngjarë që problemet lokale në shkolla të vijojnë gjatë vitit të ardhshëm akademik, duke sjellë vonesa në rihapjen e shkollave, ose në rihapje të pjesshme të tyre. Sistemet arsimore do të duhet të vazhdojnë të përshtaten me këto probleme dhe njëkohësisht të parandalojnë apo zvogëlojnë në maksimum humbjet e të nxënësve dhe të sigurojnë barazinë e mundësive dhe gjithëpërfshirjen. Nevojiten shumë parakushte që këto të arrihen, të tilla si: (1) mundësia e përdorimit dhe lidhja me TIK-un, (2) disponueshmëria e përmbajtjes cilësore *online*, (3) mësues të aftë për mësimdhënie në distancë dhe *online*, (4) mbështetja e prindërve për mësimdhënien në distancë dhe *online*, si dhe (5) koha e mjaftueshme për mësimdhënie.

### ***Mundësia e përdorimit dhe lidhja me TIK-un***

**Ndonëse shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë qasje të gjerë në televizion, çka ndihmon për të garantuar një nivel minimal barazie të mundësive, ky instrument nuk mjafton për mësimdhënie cilësore.** Si rregull, mësimdhënia e mbështetur te televizioni dhe mësimet televizive nuk janë ndërvepruese dhe nuk u përshtaten nevojave individuale të nxënësve. Megjithatë, kjo lloj mësimdhënieje ofron qasje më të barabartë të përmbajtjes mësimore, sepse i gjithë rajoni ka qasje të gjerë në televizion<sup>8</sup>. Të nxënësve *online* ka potencialin që të jetë shumë më ndërveprues se mësimet televizive, por efektiviteti i tij varet nga qasja në pajisjet digjitale, lidhja me internetin, cilësia e hartimit të përmbajtjes dhe aftësitë digjitale të mësuesit. Lëvizja në shkallë të madhe drejt të nxënësve *online* do t'u sjellë përfitime shpërpjestimore atyre nxënësve që janë të avantazhuar (p.sh. të pasurve mbi të varfrit, zonave urbane mbi ato rurale), pasi familjet me gjendje më të mirë financiare kanë më shumë gjasa që të kenë mundësi për të përdorur kompjuterë dhe internet në shtëpi, sesa nxënësit në familje më të varfra.

**Nxënësit në Ballkanin Perëndimor kanë më pak qasje ndaj internetit me shpejtësi të lartë sesa ata në BE, dhe të dhënat e rajonit paraqitin një sfidë të qartë sa i përket barazisë së mundësive.** Mesatarisht, në Ballkanin Perëndimor, rreth 60 për qind e familjeve kanë lidhje mjaftueshmërisht të shpejtë për të përballuar kërkesat për të nxënësve *online* (kjo shpejtësi përkufizohet si 10 Mbps dhe më shumë për qëllimet e kësaj analize)<sup>9</sup>. Megjithatë, duhet pasur gjithashtu parasysh se 10 Mbps janë më pak se standardet e pranueshme në SHBA (25 Mbps), apo në BE (30 Mbps). Duke përdorur këto tregues krahasimorë më të lartë, i takon që shumica e familjeve në rajon nuk janë të pajisura me internet me shpejtësi të lartë. Edhe me 10 Mbps, ka dallime të dukshme brenda rajonit. Vetëm 35 për qind e familjeve në Bosnjë-Hercegovinë kanë këtë shpejtësi interneti, në krahasim me 48 për qind në Maqedoninë e Veriut dhe 64 për qind në Serbi<sup>10</sup>. Ka gjithashtu një pjesë të madhe të nxënësve në Ballkanin Perëndimor (rreth 22 për qind),


<sup>8</sup> Për nxënësit e arsimit fillor, pronësia e televizorëve është e përhapur në Ballkanin Perëndimor (98%), çka është inkurajuese sepse transmetimi në masë është mënyra e preferuar e mësimdhënies në emergjencë për nxënësit e arsimit fillor.

<sup>9</sup> Të dhënat bazohen në raportet më të fundit nga rregulluesit kombëtarë të telekomunikacioneve.

<sup>10</sup> Po aty.

që raportojnë se kanë pak<sup>11</sup> ose aspak qasje në internet, në krahasim me vetëm 11 për qind në vendet e BE27-ës. Ajo çfarë është më e rëndësishmja, ndonëse nxënësit në kuantilin e sipërm të statusit ekonomik, social dhe kulturor (ESCS) kanë qasje gati universale në internet (përfshirë 100 për qind të këtyre nxënësve në Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe në Serbi), nuk është ky rasti për kuantilin më të ulët, dhe diferenca mund të kapë edhe 50 pikë përqindjeje (Shqipëri).

**Figura 1: Lidhja me internetin dhe qasja në pajisjet e TIK-ut në Ballkanin Perëndimor**



Burimi: PISA 2018

**Mbështetja e të nxënësve efektiv përmes metodave në distancë dhe online, veçanërisht gjatë muajve kur pandemia vazhdon, do të varet gjithashtu nga burimet e TIK-ut që do të kenë në dispozicion familjet për qëllime arsimore.** Të dhënat e PISA 2018-ës, ndonëse të kufizuara për nxënësit e arsimit të mesëm, ofrojnë një përlllogaritje të gatishmërisë së familjeve për arsimim online. Mesatarisht, një në dhjetë familje me nxënës në Ballkanin Perëndimor nuk ka kompjuter. Në Shqipëri, kjo shifër rritet me thuajse një të tretën, 28 për qind. Ka dallim të madh midis pronësisë mbi burimet e TIK-ut dhe përdorimit të tyre për arsimim. Ndërsa mesatarisht 86 për qind e nxënësve raportojnë se kanë qasje në kompjuter që mund ta përdorin për detyra shkolle, kjo përqindje ka gjasë të jetë më e ulët në raste izolimi, kur ka konkurrencë kërkesash për këto burime (p.sh., puna e prindërve nga shtëpia, arsimimi i vëllezërve/motrave). Më e rëndësishmja, hendeku socio-ekonomik në qasjen në TIK mund të jetë i madh. Nxënësit në kuantilin e sipërm të ESCS-së kanë pothuajse plotësisht qasje në internet dhe qasje të madhe në kompjuterë që mund t'i përdorin për punë. Megjithatë, siç tregohet nga Figura 1, këto shifra janë shumë më të ulëta për kuantilin e poshtëm.


### Ofrimi i përmbajtjes digjitale

**Përveç lidhjes së kufizuar, disponueshmëria dhe cilësia e përmbajtjes digjitale janë gjithashtu të dyshueshme.** Ndonëse nuk ka shumë informacion ndërshtetëror, rezultatet e PISA 2018-ës tregojnë se kjo përmbajtje dhe organizimi i saj për mbështetjen online janë mjaft të kufizuara. Ato e bëjnë gjithashtu të qartë që shumë nxënës nuk ndjekin një shkollë që ofron një platformë efektive të të nxënësve online (Figura 2). Kalimi i beftë në

<sup>11</sup> Më pak se një orë.

mësimdhënien *online* gjatë pandemisë i detyroi shkollat të kërkonin me nxitim rrugë të tjera, si mësimet e regjistruara dhe shpërndarjen e materialeve elektronike të të nxëniet përmes postës elektronike. Nuk është e qartë nëse këto materiale janë krijuar posaçërisht për mësimdhënie *online*, apo janë të improvizuara.

**Figura 2: Disponueshmëria e përmbajtjes efektive arsimore digjitale nga perspektiva e drejtorëve të shkollave**



Burimi: Rezultatet e PISA 2018-ës tregojnë përqindjen e studentëve, drejtorët e të cilëve bien dakord ose shumë dakord me pohimin.

### Aftësitë digjitale të mësuesve

**Ndonëse nuk disponohen të dhëna ndërshtetërore, ka tregues të qartë që mësuesit në Ballkanin Perëndimor nuk janë të përgatitur për të mbështetur të nxëniet efektiv *online* për shumë kohë.** Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor e pranojnë rëndësinë e aftësive digjitale, ndonëse kanë përqafuar qasje të ndryshme për zhvillimin e këtyre aftësive ndërmjet mësuesve. Për shembull, Serbia ka një kurrikul të veçantë të kompetencës digjitale për mësuesit, si dhe i kontrollon aftësitë e tyre për të përdorur teknologjitë digjitale për vlerësimin e nxënësve. Në Malin e Zi dhe në Maqedoninë e Veriut, kompetencat digjitale për mësuesit janë ndër kriteret e përgjithshme të kompetencave të tyre, ndonëse kjo nuk është e vërtetë në rastin e Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës<sup>12</sup>.

**Edhe në BE, ku lidhja digjitale në shkolla është më e zakonshme se në Ballkanin Perëndimor, vetëm 20-25 për qind e nxënësve mësojnë me mësues që e përdorin me kompetencë teknologjinë**<sup>13</sup>. Në një anketë, mësuesit në të gjithë Bashkimin Evropian i kanë përmendur shpesh aftësitë e TIK-ut si një fushë ku nevojitet zhvillim profesional për ta. Anketa "*ICT in Schools in Europe*" (TIK-u në Shkolla në Evropë) konstatoi se më shumë se 6 nga 10 nxënës evropianë mësohen nga mësues që i zhvillojnë aftësitë e TIK-ut *në kohën e tyre të lirë*<sup>14</sup>. Mësuesit në BE përmendin edhe (1) mungesën e modeleve pedagogjike se si të përdoret TIK-u për të nxënë, (2) mungesën e aftësive të duhura nga mësuesit, dhe (3) mbështetjen e pamjaftueshme teknike si pjesë e pengesave më të këqija të lidhura me mësimdhënien sa i takon përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie

<sup>12</sup> Burimi: Eurydice (2019). Arsimiti digjital në shkollë në Evropë (Digital Education at School in Europe). Nuk disponohet informacion për Kosovën.

<sup>13</sup> [https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/european-education-area/digital-education-action-plan-action-2-selfie-self-reflection-tool-mentoring-scheme-for-schools\\_en](https://ec.europa.eu/education/education-in-the-eu/european-education-area/digital-education-action-plan-action-2-selfie-self-reflection-tool-mentoring-scheme-for-schools_en).

<sup>14</sup> <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/2nd-survey-schools-ict-education>.

dhe mësimnxënie<sup>15</sup>. Përsëri, problemi ka gjasë të jetë edhe më i madh në Ballkanin Perëndimor. Edhe në Serbi, ku aftësitë digjitale identifikohen shprehimisht si kompetenca mësimore, 56 për qind e mësuesve të arsimit profesional të anketuar raportuan se kanë nevojë për një nivel të lartë ose të moderuar zhvillimi profesional në fushat e lidhura me TIK-un<sup>16</sup>.

### ***Mbështetja prindërore***

**Prindërit, të cilët janë tanimë mësues *de facto*, mund të mos kenë aftësinë, apo kohën, për të ndihmuar nxënësit.** Kjo është veçanërisht e vërtetë për nxënësit më të rinj, me performancë më të ulët dhe ata me nevoja të veçanta. Edhe në rrethanat më të mira, shumë prindër nuk janë të përgatitur për t'u përballur me të nxënësit në distancë dhe mësimin në shtëpi, veçanërisht ata që nuk kanë njohuri mbi teknologjinë, kanë arsim e burime të kufizuara, kanë shumë fëmijë për të mbajtur, dhe që duhen të marrin vendime për shpërndarjen e një numri të pamjaftueshëm pajisjesh të teknologjisë së informacionit. Për shembull, numri i të rriturve që kanë aftësi digjitale bazë apo më të mira shkon nga 24 për qind në Bosnjë-Hercegovinë, në 32 për qind në Maqedoninë e Veriut dhe në 46 për qind në Serbi, në krahasim me 56 për qind në BE27 dhe mbi 70 për qind në vende si Gjermania, Danimarka dhe Holanda<sup>17</sup>.

### ***Koha minimale për mësimdhënie***

**Koha e disponueshme për mësimdhënie, përcaktues kyç i të nxënësit, është gjithashtu thelbësore për të ndihmuar në mbështetjen e cilësisë së arsimit gjatë pandemisë, por shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë sidoqoftë kohë relativisht të vogël për mësimdhënien e kurrikulës bazë.** Përpara shpërthimit të pandemisë, sistemet shkollore të këtij rajoni kishin numër relativisht të ulët orësh mësimore për klasë në kurrikulën e detyruar, në krahasim me vendet fqinje të BE-së. Për shembull, që nga viti 2018, mesatarja e numrit minimal të rekomanduar për klasë ishte 739 orë në BE28, 628 në Serbi, 575 në Shqipëri dhe 536 në Malin e Zi<sup>18</sup>. Në periudha normale, në atë kohë, në varësi të vendit të Ballkanit Perëndimor, nxënësit që ndiqnin rregullisht shkollën, merrnin 110 deri në 200 orë mësimore më pak se ata të BE-së, pra 4 deri në 7 javë mësimore më pak për vit shkollor se mesatarja e BE-së. Kalimi drejt mësimdhënies në distancë dhe *online* do ta zvogëlojë edhe më tej kohën e mësimdhënies, veçanërisht për nxënësit e disavantazuar<sup>19</sup>.

---

<sup>15</sup> Komisioni Evropian (2019). Anketimi i 2-të i shkollave: TIK-u në arsimim. Objektivi 1: Përparimi i treguesve në TIK-un në shkolla. Raporti përfundimtar (2<sup>nd</sup> Survey of Schools: ICT in Education. Objective 1: Benchmark Progress in ICT in Schools. Final Report).


<sup>16</sup> ETF (2017) Aftësitë digjitale dhe të nxënësit *online* në Serbi. Dokumenti digjital i informacionit, tetor 2017 (ETF (2017). Digital Skills and Online Learning in Serbia. Digital Factsheet October 2017).

<sup>17</sup> Të dhëna nga Eurostat-i. Aftësitë e përgjithshme digjitale maten nga anketa e BE-së për përdorimin e TIK-ut në familje dhe nga individë. Kjo bazohet në një tregues të përbërë, që del nga veprimtari të përzgjedhura të kryera nga individët nga moshë 16 deri në 74 vjeç në internet në katër fusha të veçanta: informacioni, komunikimi, zgjidhja e problemeve dhe krijimi i përmbajtjes.

<sup>18</sup> Eurydice (2018) dhe OECD. *Shënim*: Koha minimale e rekomanduar e mësimdhënies është koha e mësimdhënies e përmendur në rregulloret apo dokumentet e politikave të autoriteteve arsimore.

<sup>19</sup> Ndërkohë, është filluar të flitet për rekomandime zyrtare për të reduktuar kurrikulën, bazuar në përpjekjet për të përmbushur pritshmëritë kurrikulare në kushtet aktuale.

**Figura 3: Koha për mësimdhënien në Ballkanin Perëndimor dhe krahasimet**



Burimi: Eurydice dhe OECD

### 3. Humbja e të nxëniet: cili është ndikimi i përlllogaritur i COVID-19-ës mbi të nxëniet në Ballkanin Perëndimor?

**Edhe përpara fillimit të pandemisë globale, sistemet arsimore të Ballkanit Perëndimor përballëshin me sfida serioze.** Në nivele të ndryshme, ato nuk ofrojnë aftësitë që kërkohen nga tregu i punës. Një vlerësim i rezultateve të PISA 2018-ës për shtet tregon se, mesatarisht, 53 për qind e nxënësve nuk marrin aftësitë bazë të nevojshme për të funksionuar në mënyrë efektive në një treg modern pune, në krahasim me 23 për qind në vendet e OECD-së (Shtojca 1). Mbi 78 për qind e 15-vjeçarëve në Kosovë, dhe mbi 50 për qind në Shqipëri, në Maqedoninë e Veriut dhe në Malin e Zi janë analfabetë funksionalë (nën Nivelin 2 të kompetencës në PISA)<sup>20</sup>. Edhe në Serbi, e cila ka rezultatet më të larta në Ballkanin Perëndimor, 38 për qind e nxënësve janë analfabetë funksionalë. Për më tepër, ka pabarazi të vazhdueshme në rezultatet e të nxëniet sipas gjinisë, vendndodhjes dhe grupit të të ardhurave. Mungesa e kompetencës në aftësitë themelore konjitive i paralizon mundësitë për të përfutur aftësi të nivelit më të lartë, për të pasur sukses në një ekonomi njohurish që ndryshon shpejt.

**Mbylljet aktuale të shkollave priten të çojnë në humbje të konsiderueshme të të nxëniet.** Mosndjekja e shkollës ka dy ndikime: nxënësit nuk mësojnë asgjë të re, dhe ata i harrojnë ato që kanë mësuar më parë. Përvoja nga kriza të mëparshme tregon se mbylljet e shkollave e ulin nivelin e të nxëniet dhe prekin në mënyrë shpërpjestimore të disavantazuarit. Në SHBA, ndikimi i recesionit 2007-09 te nëngrupet e disavantazuara tregon një ndikim afatgjatë negativ, të vogël, por gjithsesi të konsiderueshëm, në vlerësimet e testeve, si shkak i këtij recesioni<sup>21</sup>. Në vitin 2014, përmbytjet e mëdha çuan në mbylljen e shkollave në Tajlandë për një kohëzgjatje deri në një muaj, dhe në reduktimin e arritjeve të nxënësve, në varësi në lëndës dhe nivelit, nga 7 deri në 25 për qind<sup>22</sup>. Erozioni në të nxëniet gjatë një hendeuku të madh kohor përgjatë vitit shkollor (për shembull, gjatë pushimeve të verës), është dokumentuar dhe llogaritur. Mesatarisht, gjatë një pushimi veror tipik tremujor, vlerësimet e arritjeve të nxënësve ule

<sup>20</sup> Niveli 2 është niveli bazë, niveli i kompetencës ku nxënësit fillojnë të demonstrojnë kompetenca që do t'u mundësojnë të marrin pjesë në mënyrë efektive në të ardhmen si nxënës në vazhdimësi, punonjës dhe qytetarë, OECD 2017.

<sup>21</sup> Shores, K. dhe M. Steinberg. 2017. "Ndikimi i Recesionit të Madh në arritjet e nxënësve: Prova nga të dhënat e popullsisë (The Impact of the Great Recession on Student Achievement: Evidence from Population Data)." [https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract\\_id=3026151](https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3026151).

<sup>22</sup> Thamtanajit, K. 2020. "Ndikimi i fatkeqësive natyrore në arritjet e nxënësve: prova nga përmbytjet e rënda në Tajlandë" (*The Impacts Of Natural Disaster On Student Achievement: Evidence From Severe Floods in Thailand.*) *The Journal of Developing Areas* 54(4): 129-143.

me vlerën e një muaji mësimor të vitit shkollor.<sup>23</sup> Më së fundmi, duke përdorur të dhëna nga mbi gjysmë milioni nxënësish nga klasa e dytë në të nëntë, në një shtet jugor të SHBA-së (në vitin 2008-12), një studim konstatoi se gjatë verës, studentët humbnin mesatarisht 25-30 për qind të mësimëve të nxëna gjatë vitit shkollor – rreth 3 muaj të nxëni. Studimi përcakton gjithashtu se nxënësit historikisht të disavantazuar humbasin më shumë njohuri se të tjerët<sup>24</sup>. Do të duhen muaj apo vite për të kompensuar mbylljet aktuale të shkollave dhe humbjen e njohurive për këtë shkak, çka do të kërkojë reagime të menjëhershme në nivel politikash për të lehtësuar këtë ndikim, veçanërisht për ata që kanë vuajtur më shumë gjatë mbylljeve të shkollave. Nëse kjo nuk bëhet, me gjasë do të cenohet kapitali njerëzor në kuadrin afatmesëm dhe do të zvogëlohen mundësitë ekonomike në kuadrin afatgjatë.

**Për shkak se janë reagime në emergjencë, masat e të nxënimit në distancë mund të mos jenë aq efektive sa mësimdhënia në klasë – veçanërisht nëse duhet të përdoren për një periudhë të gjatë.** Shkollimi i rrit të ardhurat, veçanërisht kur lidhet me cilësinë, që matet si rregull përmes vlerësimeve nga testet. Humbja e potencialit të të nxënimit mund të vlerësohet duke përdorur vlerësimet e leximit të PISA 2018-ës<sup>25</sup>.

#### **Kutia 2. Vlerësimi i ndikimit të mbylljeve të shkollave për shkak të COVID-19-ës në humbjen e të nxënimit**

\*

Metodologjia për vlerësimin e humbjes së të nxënimit bazohet në katër supozime: (1) fitimet në të nxënimit janë lineare përgjatë gjithë vitit shkollor; (2) baza e të dhënave e PISA-s për asetet e zotëruara nga familjet ofron një vlerësim të arsyeshëm të përafërt të qasjes në metodat e mësimdhënies në distancë; (3) metodat e mësimdhënies në distancë nuk janë aq efektive sa mësimdhënia ballë për ballë në klasë, dhe (4) efektiviteti i tyre varion nga statusi socio-ekonomik i nxënësit. Mesatarisht, nxënësit fitojnë rreth 40 pikë PISA për çdo vit shkollimi. Këto numra përdoren për të vlerësuar humbjen e të nxënimit në dy skenarë: (1) të gjitha shkollat janë të mbyllura, dhe nuk ofrohen mundësi mësimi në distancë; dhe (2) ofrohet një variacion modalitetesh të mësimdhënies, me mundësinë që disa nxënës janë ende në shkolla, dhe të tjerët përfitojnë nga mësimdhënia në distancë.

Për shkak të shumë supozimeve thjeshtëzuese në këtë qasje, vlerësimet që do të rrjedhin kanë gjasë të sjellin informacione të kufizuara të humbjes reale të të nxënimit. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse humbja e punëve dhe të ardhurat më të ulëta si rezultat sjellin gjendje urie të nxënësit, apo stres për familjet, të dy këta faktorë që njihen si kufizues të të nxënimit.

\* Azevedo, Geven, Hasan, Iqbal (ende e pabotuar), *Vlerësimi i ndikimit të mbylljeve të shkollave të shkaktuara nga COVID-19 mbi rezultatet e të nxënimit (Estimating the Impact of COVID-19-Induced School Closures on Learning Outcomes), 2020*

**Vlerësimet mesatare mund të bien në kuadrin afatshkurtër, duke i kthyer disa shtete në nivelet e vitit 2015 ose më parë.** Duke supozuar se një nxënës fiton mesatarisht 40 pikë të nxëni PISA në një vit shkollor (Kutia 2), se shkollat mbyllën për katër muaj, përfshirë qershorin, se nuk ka mësimdhënie në distancë, të nxënimit në Ballkanin Perëndimor do të ulej mesatarisht me 16 pikë PISA. Në të njëjtin skenar, por duke përfshirë mësimdhënien në distancë, dhe duke supozuar se mësimdhënia në distancë nuk është aq efektive sa mësimdhënia ballë për ballë, do të kishte një ulje prej rreth 9 pikësh PISA mesatarisht në kuadrin afatshkurtër (Figura 4). Për Kosovën, kjo do të sillte një ulje të nivelit nën atë të vitit 2015 (347 pikë PISA), ndërsa për Shqipërinë, ky nivel do të binte afër atij të vitit 2012. Këto vlerësime kanë gjasë të jenë më të ulëta se realiteti, për shkak

<sup>23</sup> Cooper, Harris, Barbara Nye, Kelly Charlton, James Lindsay, dhe Scott Greathouse. 1996. "Pasojat e pushimeve verore në arritjet e vlerësimeve nga testet: Analizë dhe studim metaanalitik" (The Effects of Summer Vacation on Achievement Test Scores: A Narrative and Meta-Analytic Review.) *Summer Vacation*, 42, pages.


<sup>24</sup> Alexander, Karl, Sarah Pitcock, and Matthew C. Boulay. 2016. *Rrëshqitja verore: Çfarë dimë dhe çfarë mund të bëjmë për humbjen e të nxënimit gjatë verës (The Summer Slide: What We Know and Can Do About Summer Learning Loss)*. Teachers College Press.

<sup>25</sup> Vlerësimet e leximit përdoren për këtë analizë sepse kjo ishte lënda kryesore për PISA 2018-ën.



të shumë supozimeve thjeshtëzuese në këtë qasje, ndonëse modeli nuk merr parasysh masat e rikuperimit të diskutuara në Pjesën 4.

**Figura 4: Humbja e vlerësuar e të nxënësve me ose pa mësim në distancë nëse shkollat do të mbylleshin për katër muaj**




*Burimi:* Të dhënat e PISA 2018-ës dhe llogaritje të stafit të Bankës Botërore.


**Mbylljet e shkollave do të thellojnë pabarazinë në të nxënësve, e cila ishte e madhe dhe pa mbylljen e shkollave.** Hendeku i arritjeve ndërmjet nxënësve më të varfër dhe më të pasur, që aktualisht është nga 1,5 vjet shkollim në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë (66 pikë PISA) në mbi 2 vjet në Maqedoninë e Veriut (90 pikë PISA), ka gjasë të rritet më tej, pasi nxënësit në rrethana varfërie kanë më pak gjasa të përfitojnë nga metodat e të nxënësve në distancë. Nëse shkollat mbeten të mbyllura edhe në qershor, hendeku i përlogaritjeve rajonal mesatar i të nxënësve, ndërmjet nxënësve në kuantilin e sipërm dhe atyre në kuantilin e poshtëm, pritet të rritet nga mbi 1,5 vjet shkollimi (68 pikë PISA) në afërsisht 2 vjet (76 pikë PISA) (Figura 5).

**Shumë nxënës mund të rikthehen në analfabetizëm funksional.** Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë përqindje shumë të madhe (mesatarisht 53 për qind) nxënësish nën kompetencën elementare, në krahasim me rreth 23 për qind në vendet e OECD-së. Figura 6 tregon shkallën e ndikimit të humbjes mesatare të të nxënësve në përqindjen e nxënësve që bien nën Nivelin 2 të kompetencës, pra në analfabetizëm funksional. Duke supozuar se nxënësit që kanë pikë më të ulëta do të kenë humbje më të thella të nxënësve, numri mesatar i nxënësve që janë nën kompetencë elementare në lexim, mund të rritet nga 53 për qind aktualisht në 61 për qind. Ndikimet e këtij rezultati në politika janë të konsiderueshme: kjo nënkupton se, kur të rihapen shkollat, më shumë nxënës mund të mos e kapin nivelin minimal të pritshëm të kompetencës për moshën e tyre.

**Figura 5: Rritja e hendekut mesatar të të nxënët midis më të varfërve dhe më të pasurve nëse shkollat do të mbylleshin për katër muaj, mesatarja e Ballkanit Perëndimor**



**Figura 6: Rritja e nr. të nxënësve nën kompetencë elementare, nëse shkollat do të mbylleshin për katër muaj, mesatare e Ballkanit Perëndimor**



*Burimi:* Të dhëna nga PISA 2018, llogaritje e stafit të Bankës Botërore

**Mbylljet e zgjatura të shkollave kanë gjasë të shtojnë nxënësit që braktisin shkollën, veçanërisht ata që janë të disavantazuar pranë pikave kalimtare në ciklet arsimore.** Kërkimet e zgjeruara mbi rreziqet e braktisjes së shkollës theksojnë si çështjet e ofertës në lidhje me kushtet e shkollës, edhe çështjet e kërkesës, në lidhje me tiparet vetjake të nxënësit dhe kushtet shtëpiake. *Faktorët kryesorë të rrezikut në lidhje me shkollën* janë mungesat e shumta në klasë dhe sistemet e menaxhimit të mungesave, mbështetja e ulët akademike dhe e të nxënësve për nxënësit me arritje të ulëta, klima negative në shkollë, pjesëmarrja e ulët e nxënësve në qeverisjen shkollë, dhe angazhimi i kufizuar i prindërve. *Faktorët kryesorë të rrezikut në lidhje me nxënësin dhe familjen* janë të qenët mbi moshë në klasë, sëmundjet, problemet në sjellje, arritjet e ulëta akademike, statusi i ulët socio-ekonomik, familjet e mëdha dhe familjet me një prind<sup>26</sup>. Nxënësit në vështirësi mund të kenë më pak interes për t'u kthyer në shkollë sepse ndihen sikur nuk do të mund të kapin nivelin e klasës<sup>27</sup>. Papunësia mjaft e përhapur dhe humbja e të ardhurave nga COVID-19-a do ta vërë seriozisht në provë aftësinë e familjeve për të paguar tarifën shkollë. Kufizimet buxhetore mund t'i bëjnë familjet më të varfra që t'i mbajnë fëmijët jashtë shkolle edhe kur këto të fundit të rihapen. Të gjithë faktorët e rrezikut në lidhje me shkollën intensifikohen në situatën aktuale, kështu që nxënësit mësojnë në distancë jashtë mjedisit tipik shkollor, për javë e muaj të tërë, duke sjellë më shumë presion për mjediset familjare, veçanërisht në familjet e disavantazuara.

**Mbylljet afatgjata të shkollave kanë gjithashtu gjasë të sjellin ndikim të ndryshëm te djemtë dhe vajzat.** Për shkak se mbylljet do të rritin numrin e detyrave të kujdesit shtëpiake, vajzat shpesh do të preken më shumë se djemtë, çka do të ndikojë në aftësinë e tyre për të mbetur të angazhuara në arsimim në kuadrin më afatgjatë. Nga ana tjetër,

<sup>26</sup> Banka Botërore (2019); UNICEF (2017); UNICEF (2016)

<sup>27</sup> Banka Botërore, Pandemia e COVID-19-s: Tronditje në arsim dhe në reagimet e politikave (The COVID-19 pandemic: Shocks to Education and Policy Responses) (versioni në 12 prill 2020)

presioni për braktisjen e shkollës ka gjasë të ketë më shumë ndikim te djemtë, të cilët priren të kenë më shumë presion për të kontribuar në të ardhurat familjare, veçanërisht ndërsa përkeqësohen kushtet ekonomike. Kjo mund të sjellë braktisje të përhershme të shkollës nga djemtë, veçanërisht nga ata që ndjekin arsimin e mesëm<sup>28</sup>.

#### **4. Çfarë reagimi në nivel politikash arsimore mund të ndërmarrin shtetet për të zbutur ndikimin e COVID-19-ës?<sup>29</sup>**

**Pandemia e COVID-19-ës ka sjellë tashmë pasoja të thella në arsim dhe do të përkeqësojë çështje ekzistuese mësimore dhe pabarazitë në rajon. Zvogëlimi në maksimum i ndikimeve potenciale negative kërkon reagime agresive në politika, ndërsa shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar tanimë me përpjekjet për zbutjen.** Ndërsa nuk dihet se si do të evoluojë pandemia, është e mundur që shkollat në rajon të mos rihapen deri në vitin tjetër akademik, dhe që problemet arsimore lokale të vazhdojnë edhe vitin tjetër akademik, duke sjellë vonesa në rihapjen e shkollave, ose rihapje të pjesshme. Duhet që sistemet arsimore, më pas, të vazhdojnë të reagojnë ndaj këtyre problemeve, duke parandaluar dhe zvogëluar në maksimum humbjet në të nxënë dhe duke siguruar barazinë e mundësive dhe gjithëpërfshirjen. Megjithatë, ekzistojnë edhe reagime në nivel politikash madhore që mund të shqyrtohen nga qeveritë gjatë *fazës së përballimit*, ndërsa shkollat qëndrojnë të mbyllura, e më pas në *fazën e menaxhimit të vazhdimësisë*, në shtyrjen e rihapjes së shkollave apo në kufizimet e reduktuara të lëvizjes. Identifikohen gjithashtu politika afatmesme për të ndërtuar qëndrueshmërinë dhe për të zbutur humbjet në kapital njerëzor gjatë fazës së rikuperimit pas COVID-19-ës, kur shkollat të jenë të hapura.

##### ***Çfarë të bëhet në fazën e përballimit***

**Të vazhdohet të jepet mësim në distancë dhe të zbuten humbjet në të nxënë në mënyrë sa më të drejtë të jetë e mundur.** Ndërsa të gjitha shtetet vazhdojnë përpjekje intensive për të ofruar mësim shumëmetodik<sup>30</sup> në distancë, duhet t'u jepet përparësi aspekteve të barazisë së mundësive. Nxënësit me familje më të varfra kanë më pak qasje në lidhje interneti dhe në kompjuter në shtëpi dhe, për pasojë, kanë më pak mundësi për t'u përfshirë në mësim ndërveprues. Për të parandaluar pabarazi të mëtejshme dhe për të ulur rrezikun e braktisjes së shkollës, shtetet duhet të analizojnë mundësinë e ofrimit për këto shtresa të qasjes në internet dhe në pajisje digjitale. Maqedonia e Veriut aktualisht po ofron qasje në internet për familjet më të varfra. Mbyllja e hendekut digjital do të ndihmonte për trajtimin e problemeve që lindin ndërsa shkollat mbeten të mbyllura dhe, më vonë, për izolimet sporadike, duke ndërtuar kështu më shumë fleksibilitet të sistemit për t'u përshtatur ndaj rrethanave, për t'u përballur me situata të ngjashme nëse mbylljet e shkollave do të vazhdojnë vitin tjetër akademik.

<sup>28</sup> Banka Botërore, Pabarazitë e lidhura me gjininë që shkaktohen nga COVID-19, varfëria dhe barazia e mundësive, praktika globale (Gender Related Inequalities emerging from COVID-19, Poverty and Equity Global practice) (draft i 6 prillit, 2020).

<sup>29</sup> Kjo pjesë i referohet (1) Banka Botërore, Pandemia e COVID-19-s: Tronditje në arsim dhe në reagimet e politikave ([World Bank, The COVID-19 pandemic: Shocks to Education and Policy Responses](#)), 2020; (2) Banka Botërore, Dokument Udhëzimi: Të nxënit në distancë dhe COVID-19-a (Guidance Note: Remote Learning and COVID-19) (7 prill 2020); dhe (3) Dokument për reagimin në nivel arsimor ndaj COVID-19-ës në Evropë dhe në Azinë Qendrore (Education Response Note to COVID-19 in Europe and Central Asia) (përditësuar më 13 prill 2020)

<sup>30</sup> Një qasje shumëmetodike përmban kombinim në mënyrë origjinale të përdorimit të radiotelevizionit, SMS-së dhe medias sociale, mësimdhënies *online*, dhe materialeve të printuara për të arritur të gjithë, edhe ata pa lidhje në internet.

**Të fuqizohet mbështetja për mësuesit dhe prindërit, në mënyrë që ata t'i ndihmojnë fëmijët për të mbetur të angazhuar në shkollë.** Qeveritë në rajon kanë nxjerrë udhëzime për mësuesit për qasjet e mësimdhënies në distancë dhe *online*. Me vazhdimin e mbylljeve të shkollave, vazhdimësia e këtyre përpjekjeve dhe mbështetja e mësuesve janë kyçe. Për shembull, në shtete të tjera të BE-së dhe të Amerikës së Veriut, sistemet shkollore po u ofrojnë seanca praktike mësuesve për mësimin *online*, po rishpërndajnë ngarkesën e punës, dhe po koordinohen me mësuesit për të ulur barrët e gjithsecilit, po krijojnë përmbajtje të re për mësuesit lidhur me mënyrën e ofrimit të mësimin në distancë, duke organizuar seanca të drejtpërdrejta ku jepen udhëzime dhe eksperiencia në grup, si dhe duke bashkëpunuar me ofruesit e softuerëve. Gjithashtu, është kritike mbështetja ndaj prindërve me informacione dhe udhëzime<sup>31</sup> për ta rritur në maksimum rolin e tyre kyç mbi mbështetjen e të nxënësve kur shkollat të jenë mbyllur. Kjo është veçanërisht e vërtetë për fëmijët më të vegjël<sup>32</sup>, nxënësit me performancë më të ulët dhe ata me nevojat të veçanta.

**Të përshtatet sistemi kombëtar i vlerësimit për të siguruar një kalim më të lehtë nga një klasë e cikël në tjetrin.** Të gjitha shtetet në rajon po shqyrtojnë opsione për të trajtuar këtë çështje, sidomos kur bëhet fjalë për provimet më të rëndësishme (si provimi i maturës në Shqipëri). Në shkallë ndërkombëtare, ka pasur reagime të ndryshme. Shumë vende kanë zgjedhur t'i anulojnë apo t'i shtyjnë provimet kombëtare për vitin shkollor, për të siguruar një tranzicion më të lehtë për të gjithë nxënësit, veçanërisht për ata me rrezik braktisjeje të shkollës.<sup>33</sup> Shtete të tjera po vendosin formate të ndryshuara për provimet. Ndërsa ka shumë opsione për t'u shqyrtuar, është e rëndësishme që zgjidhjet t'i përshtaten nevojave të secilit shtet, dhe të merret parasysh qëllimi i provimit. Për shembull, për të lehtësuar vendimet për kalimet nga një klasë në tjetrën, mund të kryhen vlerësime formimi brenda klasës nga mësuesi. Në këto raste, mësuesve duhet t'u jepet orientim i qartë për të siguruar që vlerësimet e nxënësve të ndjekin udhëzimet e përbashkëta. Kur merren këto vendime, është veçanërisht e rëndësishme që vëmendja të përqendrohet te nxënësit që do të duhet të aplikojnë për nivelin tjetër arsimor në vitet shkollore 2019/2020 dhe 2020/2021. Kalimi nga një nivel në tjetrin do të kërkojë edhe më shumë mbështetje të të nxënësve në vitin shkollor vijues, ofrimin e shkollave verore, apo mbështetje të tjera si zgjidhje.

**Kur të rihapen shkollat, është e rëndësishme të analizohen në mënyrë të kujdesshme politikat dhe të shqyrtohen eksperiencat e shteteve që i kanë hapur shkollat më parë.** Në rastet kur shkollat janë rihapur, disa ndryshime kritike për parandalimin e përhapjes së virusit kanë qenë organizimi i mësimin në klasa apo nëngrupe më të vogla, kufizimi i lëvizjeve përreth shkollës, bërja e pushimeve me rradhë për klasa të ndryshme, dhe protokollat e përmirësuara të higjienës për stafin dhe fëmijët. Për shembull, në Danimarkë, ku u rihapën shkollat fillore, klasat janë ndarë në nëngrupe. Çdo fëmijë ka tavolinën e vet të vendosur 2 metra larg nga të tjerët. Mësuesit punojnë me të njëjtin grup gjatë gjithë ditës dhe nuk bëjnë zëvendësime. Fëmijët luajnë vetëm me fëmijë nga klasa e tyre, dhe vetëm në grupe të vogla. Mësuesit nuk mblidhen në sallën e mësuesve, ndërkohë që të gjithë duhet t'i lajnë duart të paktën njëherë në orë gjatë gjashtë orëve në shkollë. Këto shtete kanë vendosur përparësi për grupmosha të ndryshme ndërsa shkollat rihapen. Ndonëse shumica kanë rihapur shkollat për nxënësit

<sup>31</sup> Shumë burime të disponueshme *online* mund të përshtaten. Për shembull, Rrjeti Ndërinstitucional për Arsimit në Emergjencë (INEE) ka përpiluar një listë me burime mësimore në shumë gjuhë për të ndihmuar në orientimin e prindërve. <https://inee.org/resources/home-learning-support-parents-and-guardians>.

<sup>32</sup> Do të jetë kritike mbështetja e prindërve për ofrimin e stimulimit të hershëm, mbështetjes së të nxënësve, dhe mundësive që fëmijët të mësojnë përmes lojërave, për t'u siguruar se do të jenë gati për të mësuar.

<sup>33</sup> Provimet shkollore më të rëndësishme gjatë COVID-19-s (Coronavirus): Cila është qasja më e mirë? <https://bit.ly/2xFslq0>

më të vegjël, Austria, nga fillimi i majit të vitit 2020, ka vendosur përparësi për nxënësit që përgatiten për provimet më të rëndësishme. Në tërësi, vendimet për kohën e rihapjes së shkollave duhet të marrin parasysh aspektet e shëndetit publik lokal, dhe duhet të merren në varësi të kontekstit. Kuadri për Rihapjen e Shkollave<sup>34</sup> ofron një panoramë të hollësishme të aspekteve të kohës dhe qasjes.

### ***Menaxhimi i vazhdimësisë dhe ndërtimi i qëndrueshmërisë***

**Të ofrohen programe për shkolla verore dhe programe të tjera të mësimi të përshtetshëm për ta kompensuar humbjen e të nxënësve të fëmijët, veçanërisht për ata që rrezikojnë të mbeten prapa.** Kur të hiqen kufizimet në lëvizje, do të nevojitet përshtetshmi i mësimëve ndërsa sistemet përgatiten të rihapin shkollat. Programet e shkollave verore mund të përdoren si mundësi për të synuar nxënësit më të disavantazuar. Qeveritë mund të mendojnë për përdorimin e vlerësimeve të formimit për të gjetur hendeqet e të nxënësve dhe për t'i orientuar shkollat se si të drejtojnë mbështetjen, mësimdhënien apo këshillimin e individualizuar korrigjues. Kur të rihapen shkollat, do të duhet të zgjatet dita mësimore, në mënyrë që të gjithë nxënësit të arrijnë të kompenzojnë humbjen e të nxënësve, sidomos ata që mbeten prapa. Mësimdhënia duhet të bëhet në nivelin e duhur pas COVID-19-ës. Do të jetë kritike kryerja e vlerësimeve diagnostikuese të formimit për të vlerësuar humbjet e të nxënësve, përqendrimi te rikuperimi i të nxënësve dhe përdorimi i rezultateve të vlerësimeve të formimit për të pasur më shumë informacion në kontekstin e mësimdhënies dhe për t'i përmbushur më mirë nevojat e të nxënësve, si dhe për të përmbushur nevojat urgjente si aftësitë themelore dhe përgatitjen për provimet standarde.

**Të sigurohet financim i përshtatshëm për të mbështetur nevojat e reja të rikuperimit, veçanërisht për nxënësit e disavantazuar, kur të hapen shkollat.** Mund të nevojiten lëvizje me makinë apo fushata për reregjistrime për t'i kthyer nxënësit në shkollë, si dhe masa të përmirësuara për të menaxhuar humbjen e të nxënësve ndërsa shkollat ishin mbyllur. Meqë COVID-19-a ka gjasë të ketë ndikime të ndryshme te vajzat dhe djemtë, duhen edhe *stimuj financiarë* për të siguruar se vajzat, apo djemtë, në varësi të kontekstit, të kthehen në shkollë me rihapjen e institucioneve. Stimuj të tillë si transferta të kushtëzuara apo bursa duhet të identifikohen paraprakisht. Ofrimi i programeve nga shkollat (pra, nga ana e ofertës), në disa raste, do të jetë mënyra më efektive për zbutjen e krizës. Këto mund të përmbajnë *grante të përbashkëta për shkollat* për të lehtësuar kufizimet financiare që ndikojnë negativisht në cilësinë e të nxënësve. Këto grante mund t'u akordohen shkollave publike ku ka përqindje më të madhe nxënësish me prejardhje të disavantazuar, komuniteti rom, apo grupe me forma të tjera cenueshmërie.

**Të sigurohet dhe të përmirësohet financimi arsimor për të lehtësuar dhe parandaluar humbje të mëtejshme të të nxënësve dhe për të mbështetur përmirësimet.** Përvoja nga recesione të mëparshme tregon se, me goditjen e buxheteve qeveritare, goditen edhe shpenzimet për nxënësit për frymë. Në shkallë të ndryshme, sistemet arsimore në Ballkanin Perëndimor duhet të shpenzojnë në mënyrë më efektive, por disa, si Shqipëria dhe Kosova, duhet të investojnë më shumë edhe në sistemet e tyre. Mundësia e një buxheti arsimor të përshtatshëm për të siguruar kushte minimale për të menaxhuar kostot shtesë pas COVID-19-ës do të jetë kritik për të siguruar që nxënësit të kapin nivelin e duhur dhe që të parandalohen pabarazitë të mëtejshme. Në të njëjtën kohë, shtetet mund të rivlerësojnë financimin aktual të shkollave, përfshirë formulat financiare për përmirësimin e efikasitetit, dhe financimin suplementar për kompensimin e numrave të konsiderueshëm të nxënësve të cenueshëm. Është e rëndësishme të ngushtohet hendeuku ndërmjet pabarazive urbane dhe rurale që mbizotërojnë në të gjithë rajonin.

<sup>34</sup> <http://pubdocs.worldbank.org/en/625501588259700561/Framework-for-Reopening-Schools-APRIL27.pdf>

**Kriza mund të krijojë mundësi për reforma që do të përmirësojnë performancën e arsimimit dhe që do të krijojnë qëndrueshmëri në kuadrin afatmesëm.** Ndërsa shtetet zhvillojnë masa për rimëkëmbjen nga kriza për ta kthyer sistemin në nivelin e duhur, do të jetë kritike që t'u jepet përparësi strategjive që premtojnë përmirësime afatgjata. Situata ofron edhe një mundësi për të prezantuar novacione që janë të qëndrueshme në nivelin afatgjatë. Disa mundësi janë: (1) përmirësimi i kapaciteteve për të nxënit në distancë në shkallë të madhe dhe digjitalizimi i arsimimit për të rritur si efikasitetin, edhe përshtatshmërinë e sistemit ndaj tronditjeve të ardhshme, (2) përdorimi efikas i teknologjive për të prezantuar modele që harmonizojnë të nxënit në distancë dhe përdorime të tjera të teknologjisë me mësimdhënien e udhëhequr nga mësuesit, (3) zhvillimi i programeve trajnuese për të përmirësuar aftësitë digjitale dhe të mësimdhënies në distancë të mësuesve, (4) përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe të përkujdesjes në nivelin e fëmijërisë së hershme (parashkollor), veçanërisht për fëmijët e disavantazuar, për t'i përgatitur ata më mirë për shkollën, sidomos si rrjedhojë e faktit se arsimi parashkollor mund të jetë përkeqësuar për shkak se prindërit i japin më shumë përparësi mësimit të fëmijëve më të rritur, dhe (5) matja e efikasitetit në sistemin arsimor dhe rritja e cilësisë së të dhënave të menaxhimit.